



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1338 / 12 prot.

Tiranë, më 12/09/2022

URDHËR

Nr. 177 / 11, datë 12.09.2022

PËR

MIRATIMIN E PAKETËS SË PROGRAMIT TË DEPISTIMIT TË SHËNDETIT DHE KUJDESIT DENTAR PËR FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6-14 VJEÇ NË SHKOLLA


Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit Nr. 10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe të neneve 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 9928, datë 09.06.2008, "Pëe shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, relacionit të grupit të grupit të punës të ngritur me Urdhërin nr. 177 datë 18.03.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit të depistimit të shëndetit dhe kujdesit dentar për fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç në shkolla",

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Programit Kombëtar për depistimin e kujdesit dentar për fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç në shkolla, si një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, me qëllim identifikim e hershëm të patologjive orale, dëmtimeve të dhëmbëve, parandalimin, edukimin shëndetësor dhe ofrimin e shërbimit profilaktik dhe mjekues stomatologjik në strukturat publike shëndetësore dhe institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori Qendror i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Klinika Stomatologjike Universitare të ndjekin zbatimin e këtij urdhri sipas fushës së vet të veprimitarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Ogerta Manastirliu



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

PROGRAM KOMBËTAR

PËR

DEPISTIMIN DHE KUJDESIN DENTAR
TE FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6-14 VJEÇ

Përmbajtja

I. ANALIZA E SITUATËS DHE NEVOJAVE AKTUALE PËR KUJDESIN DENTAR TË FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS 6-14 VJEC	4
1.1 Shëndeti Oral në kontekstin Global	4
1.2 Shëndeti Oral në Shqipëri	5
1.3 Sëmundjet Orale	8
1.4 Organizimi i shërbimit stomatologjik pubik në nivel kombëtar	10
II. KUADRI STRATEGJIK I PROGRAMIT TË DEPISTIMIT DHE KUJDESIT DENTAR TE FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6-14 VJEÇ	13
2.1 Vizioni	13
2.2 Qëllimi	13
2.3 Objektivat	14
2.4 Qasja Strategjike	14
2.5 Modeli i Ofrimit të shërbimit të shëndetit oral	15
2.6 Organizimi i Sistemit të Referimit sipas Diagnozave dhe trajtimeve për nivele shërbimi	16
2.7 Fushat prioritare të veprimit.....	17
2.8 Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Veprimit	18
III. PLANI I IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT TË DEPISTIMIT TË SHËNDETIT DHE KUJDESIT DENTAR PËR FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6 - 14 VJEÇ NË SHKOLLA	19

1. ANALIZA E SITUATËS DHE NEVOJAVE AKTUALE PËR KUJDESIN DENTAR TË FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS 6-14 VJEC

1.1 Shëndeti Oral në kontekstin Global

Studimi i Barrës së Sëmundshmërisë Globale në vitin 2019 vlerësoi se sëmundjet orale prekin afro 3.5 miliardë njerëz në mbarë botën, ku kariesi i dhëmbëve të përhershëm është patologjia më e zakonshme. Në nivel global, vlerësohet se 2 miliardë njerëz vuajnë nga kariesi i dhëmbëve të përhershëm dhe 520 milionë fëmijë vuajnë nga kariesi i dhëmbëve të qumështit.

Shumica e faktorëve etilogjikë të patologjive të shëndetit oral janë kryesisht të parandalueshme dhe mund të trajtohen në fazat e tyre të hershme. Pjesa më e madhe e rasteve janë kariesi i dhëmbëve (prishja e dhëmbëve), sëmundjet periodontale, kanceri i gojës, trauma orto-dentare, çarja e buzës dhe qiellzës dhe stomatiti ulçeroz (sëmundje e rëndë gangrenoze që fillon në gojë dhe prek më së shumti fëmijët). Në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme, prevalenca e sëmundjeve orale vazhdon të rritet me urbanizimin në rritje dhe ndryshimet në kushtet e jetesës. Kjo vjen kryesisht për shkak të ekspozimit joadekuat ndaj fluorit (në furnizimin me ujë dhe produktet e higjienës orale si pasta e dhëmbëve), disponueshmërisë dhe përbalueshmërisë së ushqimit me përmbajtje të lartë sheqeri dhe aksesit të dobët në shërbimet e kujdesit shëndetësor oral në komunitet. Tregtimi i ushqimeve dhe pijeve me përmbajtje të lartë sheqeri, si dhe i duhanit dhe alkoolit, kanë çuar në një konsum në rritje të produkteve që kontribuojnë në kushtet e shëndetit oral dhe sëmundje të tjera jo të transmetueshme.

Fakte kryesore

- Në gjithë botën, 60-90% e fëmijëve të moshës shkollore vuajnë nga kariesi dentar.
- Incidenca e kancerit oral shkon nga 1 deri në 10 raste për 100.000 njerëz në shumicën e vendeve.
- Vetëm 60% e popullsisë botërore ka akses në kujdesin shëndetësor oral.
- Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rreth 90 % e popullsisë së botës do të vuajnë të paktën një herë gjatë jetës së tyre nga një sëmundje e gojës, duke filluar nga kariesi dhe sëmundjet periodontale, të cilat çojnë në prishjen e dhëmbëve dhe kancerin e gojës
- Dhembja e dhëmbit është një ndër arsyet kryesore për mungesat e nxënësve në shkollë. Sot, në shumë vende të botës, rreth 60-90% e fëmijëve të moshës shkollore dhe afërsisht 100% e të rriturve kanë probleme me shëndetin e gojës. Në botë, rreth 30% e njerëzve midis moshës 65-74 vjeç nuk kanë dhëmbë natyralë në gojën e tyre. Rreziku për t'u prekur nga kanceri oral është 15 herë më i lartë kur kombinohen bashkë dy faktorët kryesorë të rrezikut, duhani dhe alkooli.

Sot në botë, 16-40% e fëmijëve të moshës 6 deri 12 vjeç janë të prekur nga traumat dentare për shkak të terreneve sportive, shkollave të pasigurta apo aksidenteve rrugore. Në vendet e zhvilluara barra e sëmundjeve orale është në rënie, ndërsa komplikacionet janë më të zakonshme, sidomos te pjesa më e moshuar e popullsisë.

Faktorët kryesorë të rrezikut si përdorimi i duhanit, pasiviteti fizik dhe ushqimet jo të shëndetshme (konsumi i tepert i sheqerit dhe yndyrnave) rritin ndjeshëm rrezikun për t'u prekur nga sëmundje të ndryshme të gojës. Konsumi i lartë i sheqerit është faktori kryesor i cili mund të sjellë prishjen e dhëmbëve.

Barra ekonomike për shkak të shëndetit të dobët oral dhe të sëmundjeve orale në mbarë botën përbëjnë 545 miliardë dollarë në kosto direkte dhe indirekte, duke renditur shëndetin i dobët oral ndër fushat më të kushtueshme shëndetësore, si diabeti dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Gjithashtu duke marrë parasysh se shëndeti i dobët oral përveç dhimbjes, shqetësimit dhe mungesës së mirëqenies dhe cilësisë së jetës, çon në mungesa në shkollë dhe në vendin e punës, duke çuar në mangësi në mësim dhe humbje të produktivitetit.

1.2 Shëndeti Oral në Shqipëri

Sipas Shoqatës së Stomatologëve Shqiptarë, sëmundjet e gojës janë më të përhapurat dhe prekin rreth 90% të popullsisë. Ato kanë një impakt domethënës në shëndetin e përgjithshëm të çdo individ.

Shërbimi Stomatologjik Publik i Tiranës ka bërë studime mbi shtrirjen e prishjes së dhëmbëve në moshat 6 dhe 12 vjeç, sikurse edhe mbi ashpërsinë e saj. Sipas studimit të vitit 2017, te fëmijët 6-vjeçarë të rajonit të Tiranës kemi vetëm 24.2% individë që nuk kanë asnjë dhëmb qumështi të prishur në gojë dhe 80.2% që nuk kanë asnjë dhëmb të përhershëm të prekur.


Shpeshtësia e individëve të paprekur nga kariesi në moshën 12-vjeçare bie në 20% dhe në 10% në moshën 15-vjeçare.

Të dhënat tregojnë se fëmijët e moshës 6-vjeçare kanë mesatarisht 4 dhëmbë qumështi të prishur, 0.34 dhëmbë të përhershëm të prishur dhe 87% të dhëmbëve të prishur të pamjekuar.

Kjo shifër e fundit dëshmon fuqishëm nivelin e kujdesit që i kushtojnë prindërit dhëmbëve të përkohshëm të fëmijëve dhe mungesën e informacionit për rëndësinë e tyre në ecurinë e shëndetit oral të fëmijëve.


1.2.1 Prevalenca e sëmundjes karioze dhe treguesi i nevojës normative

DMFT mesatare në varësi të moshës




* $D/DMFT \times 100 = 51.54\%$

Prevalenca sipas grupmoshës




*Prevalenca rritet me rritjen e grupmoshës ($\chi^2: P < 0.044$)




*NN = Nevoja normative

1.2.2 Prevalenca e sjelljeve të shëndetshme lidhur me kujdesin për shëndetin oral

Larja e dhëmbëve 2 herë në ditë




Përdorimi i Ushqimeve/pijeve të ëmbla ≤ 3 herë në ditë




1.2.3 Sjelljet e lidhura me kujdesin për shëndetin oral

Përdorimi i fillit dentar dhe solucioneve për shpërlarjen e gojës



Nevoja për të përmirësuar sjelljet



1.3 Sëmundjet orale

Shtatë sëmundje dhe çrregullime orale përbëjnë pjesën më të madhe të barrës së shëndetit oral. Ato përfshijnë kariesin e dhëmbëve (prishjen e dhëmbëve), sëmundjet periodontale (mishrat e dhëmbëve), kanceret, manifestimet orale të HIV-it, traumën oro-dentare, çarjen e buzëve dhe qiellzës dhe noma. Pothuajse të gjitha sëmundjet dhe gjendjet janë ose kryesisht të parandalueshme ose mund të trajtohen në fazat e hershme të tyre.

Me rritjen e urbanizimit dhe ndryshimeve në kushtet e jetesës, përhapja e sëmundjeve orale vazhdon të rritet veçanërisht për shkak të ekspozimit jo adekuat ndaj fluorit dhe tregtimi i rëndë i sheqernave, duhanit dhe alkoolit i cili çon në rritjen e konsumit të produkteve jo të shëndetshme.

I. Kariesi dentar (prishja e dhëmbëve)

Kariesi i dhëmbëve rezulton kur pllaka mikrobiale formohet në sipërfaqen e dhëmbit. Me vazhdimin e konsumit të lartë të sheqerit, ekspozimit jo adekuat ndaj fluorit dhe mos pastrimit të rregullt të biofilmës mikrobike, strukturat e dhëmbëve shkatërrohen, duke rezultuar në zhvillimin e zgavrave dhe dhimbjeve, ndikime në cilësinë e jetesës të lidhura me shëndetin e gojës dhe infeksionit sistemik.

II. Humbja e dhëmbëve

Kariesi i dhëmbëve dhe sëmundjet parodontale janë shkaqet kryesore të humbjes së dhëmbëve. Humbja e rëndë e dhëmbëve dhe edentulizmi (rënia e dhëmbëve natyralë) janë të përhapura dhe veçanërisht shihen tek njerëzit e moshuar.

III. Kanceri oral

Kanceri oral përfshin kancer të buzëve dhe zgavrës së gojës. Incidenca e kancerit oral në botë vlerësohet 4 raste për 100.000 njerëz. Ky lloj i kancerit është më i zakonshëm tek burrat, tek njerëzit e moshuar dhe ndryshon fuqimisht nga gjendja socio-ekonomike.

IV. Manifestimet gojore të infeksionit HIV

Ky lloj i infeksionit ndodh në 30-80% të personave me HIV, me ndryshime të konsiderueshme në varësi të situatave të tilla si përballueshmëria e terapisë standarde antiretrovirale (ART). Këto çrregullime përfshijnë infeksione kërpudhore, bakteriale ose virale nga të cilat kandidiaza orale është më e zakonshme. Lezionet e gojës HIV shkaktojnë dhimbje, siklet, tharje të gojës, kufizime në të ngrënë dhe janë një burim i vazhdueshëm i infeksionit oportunist.

V. Parandalimi

Sëmundjet orale dhe SJT-të e tjera mund të shërohen përmes ndërhyrjeve të shëndetit publik si dhe duke adresuar faktorët e zakonshëm të rrezikut.

Kjo përfshin:

- promovimi i një diete të ekuilibruar mirë
- sheqerna të ulëta për të parandaluar zhvillimin e kariesit dentar, humbjen e parakohshme të dhëmbëve dhe NCDs të tjera të lidhura me dietën
- me konsum adekuat të frutave dhe perimeve, të cilat mund të kenë një rol mbrojtës në parandalimin e kancerit oral
- ulja e pirjes së duhanit, përdorimi i duhanit pa tym dhe uljen e konsumit të alkoolit për të zvogëluar rrezikun e kancerit oral, sëmundjeve periodontale dhe humbjen e dhëmbëve
- inkurajimi i përdorimit të pajisjeve mbrojtëse kur bëni sport dhe udhëtoni në automjete për të zvogëluar rrezikun e lëndimeve të fytyrës

Përveç faktorëve të zakonshëm të rrezikut, ekspozimi jo adekuat ndaj fluorit dhe një numër i përcaktuesve social të shëndetit duhet të adresohen për të parandaluar sëmundjet e gojës dhe për të zvogëluar pabarazitë e shëndetit oral.

1.4 Organizimi i shërbimit stomatologjik publik në nivel kombëtar

Shërbimi stomatologjik publik është i organizuar dhe funksionon në zbatim të LIGJIT Nr.9928, datë 9.6.2008 “PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, VKM Nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, Rregulloren e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, neni 24, kreu II/2.

Shërbimi stomatologjik është strukturë në varësi të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në 36 rrethe dhe ofron shërbim për fëmijët në grup moshat 0-18 vjeç, për veteranët, invalidët, PAK dhe popullsinë rome. Kabinetet dentare të shkollave ofrojnë shërbime palandaluese, trajtime urgjence dhe pjesërisht kurative, si dhe aktivitet shkencor.

Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese/edukim shëndetësor të kryera nga kabinetet dentare të shkollave dhe numri i trajtimeve të rasteve urgjente të kryera nga kabinetet dentare, janë disa prej të dhënave që grumbullohen në menyrë periodike.

1.4.1 Kabinetet dentare të shkollave

Kabinetet dentare të shkollave ofrojnë shërbime parandaluese parësore dhe dytësore, ku përmblihen trajtimet parandaluese, trajtimet kurative (pjesërisht), trajtimet e urgjencës dhe aktiviteti shkencor.

1. Në shërbimet parandaluese bëjnë pjesë:

a) **Depistimi:** nënkupton një kontroll të përgjithshëm të nxënësve, që bëhet kryesisht nëpër klasa, dy herë në vit. Për t’i dalluar nga llojet e tjera të vizitave, njihen si ekzaminime epidemiologjike, sepse qëllimi kryesor i tyre është identifikimi i patologjisë në stadet e hershme të saj dhe klasifikimi i individëve në individë me probleme dhe pa probleme të shëndetit të gojës e të dhëmbëve. Depistimet janë pjesë e parandalimit parësor (klasifikimi i individëve me risk të lartë për patologji dhe dhënia e këshillave për parandalimin e saj) dhe e parandalimit dytësor (rekomandimi për ndërhyrje në stadet e hershme). Depistimet kanë edhe funksion edukues, sepse synojnë t’i edukojnë nxënësit me idenë e kontrolleve periodike nga dentisti (dy herë në vit).

Depistimet pasqyrohen në kartelën dentare të çdo nxënësi. Këtu hidhen të dhëna lidhur me higjienën e gojës, praninë ose jo të anomalive të dhëmbëve dhe të nofullave, gjendjen e dhëmbëve (faqja e parë dhe e dytë e kartelës). Për çdo patologji të identifikuar në gojën e një nxënësi, që nuk bën pjesë në kategoritë e mësipërme, mund të mbahen shënime në faqen e fundit të kartelës.

- b) **Vizitat në kabinet:** janë vizita diagnostikuese, me qëllim vendosjen e një diagnoze të saktë dhe dhënien e rekomandimit për trajtimin e nevojshëm ose kryerjen e trajtimit në kabinet, kur kjo është e mundur. Këto janë pjesë e parandalimit dytësor dhe tretësor, që patologjia të mos shtrihet më tej. Koha e një vizite është llogaritur minimalisht 20 minuta.
- Vizitat në kabinet shënohen vetëm në regjistër, por sipas rastit mund të mbahen edhe shënime në kartelë (në varësi të llojit të patologjisë, nevojës për ndërhyrje, prognozës etj). Shënime specifike mund të shtohen në fushën “shënime” në regjistër.
- c) **Pastrimi profesional i pllakës bakteriale (i cipave dhe i gurëzave):** Mund të kryhet vetëm nga kabinetet që kanë një aparaturë që e mundëson këtë procedurë, por mund të kryhet edhe me dorë me instrumentet përkatëse. Kjo e dyta gjithsesi është një procedurë traumatike dhe jo çdo nxënës pranon t’i nënshtrohet. Një pastrim profesional zgjat minimalisht 30 minuta.
- d) **Fluorizimi profesional me xhel fluorid:** për parandalimin e prishjes së dhëmbëve, ka filluar në shërbim në vitin 2014. Ky realizohet në bazë të një udhëzuesi të brendshëm (“Udhëzime për aplikimin e xhelit të fluorit”). Një procedurë fluorizimi zgjat minimalisht 20 minuta. Për aplikimin e xhelit të fluorit te fëmijët njoftohen edhe prindërit dhe merret miratimi paraprak i tyre.
- e) **Silanimet:** janë veshje profesionale të sipërfaqeve të dhëmbëllëve, dhe ndihmojnë për të parandaluar prishjen në sipërfaqet përtpëse të dhëmbëllëve dhe të paradhëmbëllëve, mund të ofrohen nga kabinetet që kanë një llambë fotopolimerizuese dhe ose aparaturë me funksione të pjesshme. Një procedurë silanimit zgjat minimalisht 30 minuta.
- f) **Edukimi shëndetësor:** është një pjesë e rëndësishme e punës së mjekëve stomatologë të shkollave, që kryhet në forma të ndryshme: leksione PPT me kompjuter dhe projektor, bashkëbisedime nëpër klasa ose me grupe në kabinet, këshilla individuale gjatë depistimeve dhe vizitave, demonstrime të teknikës korrekte të larjes së gojës, spektakle, ekspozita etj. Tematika e edukimit shëndetësor është e larmishme dhe përfshin informacion mbi parandalimin e patologjive të dhëmbëve, anomalive të dhëmbëve dhe të nofullave, higjienën e gojës, sikurse edhe tema më të gjera si ndërgjegjësimi për HIV/AIDS, dëmet që shkaktojnë duhani, alkooli dhe drogat në zgavrën e gojës në veçanti dhe në organizëm në përgjithësi. Procesi i edukimit shëndetësor ka pasur në qendër nxënësit dhe mbështetëj mbi dy parime bazë: mësim nxënia aktive dhe transmetimi horizontal i informacionit nga njëri fëmijë te tjetri, si dy mënyra efikase për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të fëmijëve për kujdesin që duhet të kenë për veten.

g) **Larja e dhëmbëve:** është një ndërhyrje e drejtpërdrejtë për t'u mësuar nxënësve konceptet e higjienës së gojës dhe për të korigjuar teknikat e gabuara që përdorin ata. Edhe kjo kryhet sipas mundësive që ofrojnë drejtoritë e shkollave.

1.4.2 Raporti me të dhënat e shërbimit stomatologjik sipas rajoneve

Shërbimi stomatologjik, në nivel të shërbimit parësor është pjesë e strukturës së 36 Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor, dhe në të 4 rajonet kemi një numër total prej 227 stomatologë nga të cilët 151 prej tyre janë stomatologë të cilët ofrojnë shërbim në institucionet arsimore të ciklit të ulët dhe të mesëm.

Shërbimi stomatologjik ofrohet nëpërmjet Punteve Stomatologjike dhe Uniteve Dentare të vendosura brenda institucioneve arsimore. Nëpër shkolla ofrohen vizitat (depistimet dhe vizitat në kabinet), trajtime parandaluese (fluorizim, silante, pastrime profesionale të dhëmbëve) dhe trajtime mjekuese (në varësi të materialeve dhe amortizimit të aparaturave).

Shërbimi stomatologjik shkollor ofron trajtime stomatologjike për rreth 300 mijë fëmijë të moshës 0-14 vjeç. Gjithsej shërbimi stomatologjik parësor ka 151 unite dentare të cilat gjenden të shpërndara nëpër shkolla në të gjithë vendin, ku rajoni i Tiranës ka numrin më të madh prej 65 unite.

Gjithashtu, në të gjithë NJVKSH gjenden të lokalizuar dhe 47 punkte, me 73 unite dentare që ofrojnë shërbim dhe për të rriturit që i përfitojnë këto trajtime falas.

2. KUADRI STRATEGJIK I PROGRAMIT TË DEPISTIMIT DHE KUJDESIT DENTAR TE FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6-14 VJEÇ

Programi kombëtar për depistimin e shëndetit oral dhe kujdesit dentar për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç në shkolla, do të jetë një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, me qëllim identifikimin e hershëm të patologjive orale, dëmtimeve të dhëmbëve, parandalimin, edukimin shëndetësor dhe ofrimin e shërbimit profilaktik dhe mjekues stomatologjik në strukturat publike shëndetësore dhe institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.

2.1 Vizioni

Që të gjithë fëmijët shqiptarë të gëzojnë një gjendje të shëndetit oral optimal - pa dhimbje kronike, prishje apo humbje të dhëmbëve.

2.2 Qëllimi

Qëllimi kryesor i Programit kombëtar për depistimin e shëndetit oral dhe kujdesit dentar është përmirësimi shëndetit oral tek fëmijët e moshës shkollore me anë të identifikimit të hershëm të patologjive orale, parandalimit, edukimit shëndetësor dhe ofrimit të shërbimit profilaktik dhe mjekues stomatologjik.

2.3 Objektivat

- Depistim periodik në strukturat publike shëndetësore dhe institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm tek fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç
- Edukim shëndetësor periodik në moshat nga 6 – 14 vjeç në të gjithë institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.
- Shërbim profilaktik dhe mjekues stomatologjik për moshat nga 6 – 14 vjeç në të gjithë institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.

2.4 Qasja strategjike

Një qasje gjithëpërfshirëse që integron në mënyrë sistematike politikat dhe veprimet për të zvogëluar rreziqet në shëndetin oral dhe trajtimin e tyre në të njëjtën kohë:

1. **Ndërhyrjet parandaluese:** Vetëm trajtimi i sëmundjes në fazën përfundimtare nuk do të arrijë përmirësime thelbësore në gjendjen e shëndetit oral – vetëm një investim i rëndësishëm në masat parandaluese do të shmangë shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve orale.
2. **Praktikë e bazuar në dëshmi:** Programet dhe shërbimet e kujdesit për shëndetin oral do të ofrohen sipas hulumtimit dhe bazuar në praktikatat më të mira.
3. **Përqasja e shëndetit të popullsisë:** Ndërhyrjet me efekte të përhapura dhe ato që krijojnë një kulturë promovuese të shëndetit në tërësi drejt shëndetit oral do të përmirësojnë gjendjen e shëndetit oral të të gjithë popullatës dhe do të reduktojnë pabarazitë shëndetësore.
4. **Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë:** Sigurimi i cilësisë do të arrihet përmes vlerësimit të programit dhe mbikëqyrjes së shëndetit oral për moshat nga 6 – 14 vjeç, duke ofruar një kujdes shëndetësor oral me cilësi të lartë.

2.5 Modeli i ofrimit të shërbimit të shëndetit oral

Programi kombëtar për depistimin e shëndetit oral dhe kujdesit dentar për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç në shkolla është një komponent qendror në unifikimin e ofrimit të shërbimit të shëndetit oral. Është një model shërbimi i bazuar në fakte dhe me kosto efektive, i cili thekson parandalimin e sëmundjeve orale dhe identifikimin e hershëm të sëmundjes, si dhe integrimin e shërbimeve të shëndetit oral në kujdesin shëndetësor parësor dhe mjediset shkollore.

Klinika Stomatologjike Universitare dhe Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor janë dy aktorët kryesor në implementimin e këtij programi.

Vlerësimi i kujdesit dentar, kurrikula e edukimit shëndetësor periodik si dhe shërbimi profilaktik dhe mjekues do të bazohen në protokollet e miratuara nga Klinika Stomatologjike Universitare. Gjithashtu përgatitja e kartelës individuale për të gjithë fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç do të jetë e diktuar nga Shërbimi i Pedodontisë në KSU. Ndërsa përgatitja e një regjistri kombëtar për problemet e shëndetit dentar të fëmijëve nga Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.

Depistimi tek të gjithë fëmijët kryhet nga mjekët stomatolog në institucione shëndetësore publike dhe institucionet arsimore të nivelit të detytueshëm, sipas protokolleve të përcaktuara. Të gjithë fëmijët e kësaj grupmoshe do të depistohen dy herë në vit sipas një kalendarit të përcaktuar nga mjeku stomatolog i atashuar në kabinetet dentare në institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm ose punktet e stomatologjisë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Gjatë depistimit, personeli shëndetësor dokumenton rezultatet e depistimit dhe të mjekimit në një regjistër të veçantë me të dhënat bazë të nxënësit.

Fëmijët që rezultojnë me probleme gjatë depistimit, rekomandohen nga mjekët stomatolog, për shërbime profilaktike dhe mjekuese stomatologjike në institucionet publike ose në punktet dentare sipas rajonit, sipas sistemit të referimit, ku për shërbime të specializuara rekomandohen në Klinikën Stomatologjike Universitare.

Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe Klinika Stomatologjike Universitare do të hartojnë planin e shtrirjes së programit në përshtatje me axhendën shkollore, ndërsa organizimi i programit të depistimit të kujdesit të shëndetit dentar për fëmijët do të ndiqet dhe monitorohet nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Të dhënat për çdo përfitues të këtij programi analizohen nga Klinika Stomatologjike Universitare pas raportimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Në zonat rurale ku nuk ofrohet shërbimi i depistimit dhe kujdesit të shëndetit dentar në shkolla apo punkte, do të ofrohet nëpërmjet dy kabineteve dentare të lëvizshme. Protokollat e trajtimit, stafi, materialet e mjekimit dhe monitorimi i ofrimit të shërbimit nga kabinetet e lëvizshme do të kryhet nga Klinika Stomatologjike Universitare e cila do të publikojë njëherë në vit në faqen zyrtare të internetit kalendarin vjetor të lëvizjes së kabineteve dentare të lëvizshme.

Promocioni dhe edukimi shëndetësor i shërbimeve që do të kryhet nga kabinetet dentare të lëvizshme në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.

2.6 Organizimi i Sistemit të Referimit sipas Diagnozave dhe trajtimeve për nivele shërbimi:

Shërbimi dentar për fëmijët që do të rezultojnë me probleme gjatë depistimit, do të rekomandohen nga mjekët stomatolog në institucionet publike ose në punktet dentare sipas rajonit, sipas sistemit të referimit i cili është i organizuar sipas diagnozave në nivele shërbimi:

A. Shërbimi primar në shkollë:

1.1 Edukim shëndetësor i cili kryhet në forma të ndryshme si bashkëbisedime nëpër klasa për rëndesinë e higjenes orale, demonstrime të teknikës korrekte të larjes së gojës, aktivitete të ndryshme për ndergjegjesim.

1.2 Depistimin e përgjithshëm të nxënësve të shkolles çdo 4 muaj;

- 1.3 Vizita diagnostikuese e kavitetit oral me qëllim vendosjen e diagnozes,
- 1.4 Pastrimi profesional i pllakës bakteriale (i cipave dhe i gurëzave)
- 1.5 Fluorizimi profesional me xhel fluori, për parandalimin e prishjes së dhëmbëve;
- 1.6 Silanimet, që janë veshje profesionale të sipërfaqeve të dhëmballëve;
- 1.7 Kartelizim i cdo femije për cdo problem të shëndetit oral
 - 1.7.1 Higjiena e tij
 - 1.7.2 Kariesin
 - 1.7.3 Deformime në rreshtimin e dhembëve apo probleme të nofullave

B. Shërbimi sekondar në shkollë dhe në cdo pike ku kemi mjek stomatolog (Punkti Dentar):


- 2.1 Mjekimin e dhembëve të qumeshtit
 - 2.1.1 Kariesin
 - 2.1.2 Mjekim endodontik
 - 2.1.3. Extraksion
- 2.2 Mjekimin e dhembëve permanent
 - 2.2.1. Kariesin sipas gradave të ndryshme
 - 2.2.2. Mjekim endodontik
 - 2.2.3. Extraksion
- 2.3 Mjekimin e indeve të buta
- 2.4 Rekomandim për KSU për deformime në rreshtimin e dhembëve apo probleme të nofullave

C. Shërbimi terciar, Klinika Stomatologjike Universitare

- 3.1 *Mjekimin e dhembëve të qumeshtit për femije me nevojë të vecanta ose odontofobik*
 - 3.1.1. Kariesin
 - 3.1.2. Mjekim endodontik
 - 3.1.3. Extraksion
- 3.2 *Mjekimin e dhembëve permanent*
 - 3.2.1. Kariesin sipas gradave të ndryshme për femije me nevojë të vecanta ose odontofobik
 - 3.2.2. Mjekim endodontik
 - 3.2.3. Kanale të obteruar
 - 3.2.4. Grada e IV- infeksione të ndryshme
- 3.3 *Extraksion*
 - 3.3.1 Extraksione të dhembëve të impaktuar
 - 3.3.2 Mjekimin e indeve të buta
- 3.4 *Deformime në rreshtimin e dhembëve, malokluzione apo probleme të nofullave*
 - 3.4.1 Trajtimi i problemeve dentare me aparate të ndryshme biofunktionale
 - 3.4.2 Trajtimi i malokluzioneve apo probleme të nofullave me aparate, ndërhyrje kirurgjikale.
- 3.5. *Të sëmurët e shtruar dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike, për mjekime urgjence;*
- 3.6. *Kategori të veçanta individësh sic janë PAK, NE, veteranet etj.*
- 3.7. *Aktiviteti shkencor dhe aftësimi i vazhdueshëm shkencor*

2.7 Fushat prioritare të veprimit

Objektivat dhe ndërhyrjet prioritare janë të organizuara brenda katër fushave strategjike: qeverisja, parandalimi dhe sistemi shëndetësor.



2.7.1 Qeverisja dhe Koordinimi

Prioritet:

1. Riorganizimi dhe fuqizimi i shërbimit të stomatologjisë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
2. Fuqizimi i punkteve të stomatologjisë pranë shkollave dhe Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor me pajisje të reja mjekësore.
3. Fuqizimi me pajisje mjekësore i Klinikës Stomatologjike Universitare
4. Fuqizimi i pikave fokale përgjegjës për kujdesin dentar në nivel rajonal
5. Koordinim informacioni mes KSU, OSHKSH dhe MSHMS për raportet monitoruese
6. Ndërtim i ekipeve multidisiplinare mbi kujdesin dentar në nivel sistemi shëndetësor lokal
7. Forcimi i bashkëpunimit me bashkitë për përmirësimin e shëndetit dentar të fëmijët

2.7.2 Parandalimi : Aplikim i masave rregullatore

I. Masa në nivel qeverisje vendore dhe qendrore

1. Kufizim i tregëtimit të produkteve me përmbajtje të lartë sheqeri, kripe dhe mishi industrial tek fëmijët
2. Rregullim i shitjes së produkteve ushqimore në mjedise shkollore

II. Ndërhyrje në popullatë

1. Rritja e njohurive mbi kujdesin dentar, menaxhimin e faktorëve të riskut, sjelljen e shëndetshme etj

2. Fushata mbi ushqyerjen e shëndeteshme dhe mbështetjen e ushqimeve lokale.
3. Promovimi i ushqyerjes së shëndetshme dhe aktivitetit fizik në mjediset shkollore
4. Përdorimi metodave inovative për të ndikuar në rrjetet e mediave sociale me modele të sjelljes së shëndetshme
5. Adaptimi i aftësive të diagnozës dhe komunikimit të mjekëve për pacientët e vegjël me probleme të shëndetit mendor

2.7.3 Sistemi shëndetësor: ulja e barrierave në akses

1. Ofrimi i shërbimit të kujdesit dentar për zonat rurale të thella për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç nëpërmjet klinikave dentare të lëvizshme.
2. Ofrimi i shërbimit të kujdesit dentar pranë vendbanimit për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç

2.8 Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Veprimit

Monitorimi i planit të veprimit mbi SJT do të drejtohet nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe do të kryhet nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen dhe mbështetjen teknike të përfaqësuesve nga institucionet kryesore kombëtare përgjegjëse për shëndetin dentar.

Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik dhe analizimin e progresit dhe problemeve në secilën prej politikave prioritare. Raporti i standartizuar do të përmbajë fakte dhe të dhëna të standartizuara, bazuar në kornizën e indikatorëve të parashikuar nga ky program kombëtar.

3. PLANI I IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT TË DEPISTIMIT TË SHËNDETIT DHE KUJDESIT DENTAR PËR FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6 – 14 VJEÇ NË SHKOLLA

Objektiva	Aktivitetet	Tregues te procesit	Koha	Institucione	Partnere	Kosto
Fusha 1. Qeverisja dhe koordinimi						
Objektiva	Aktivitetet	Tregues	Koha	Institucione	Partnere	Kosto
Riorganizimi dhe fuqizimi i shërbimit të stomatologjisë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor të Kujdesit Shëndetësor	Përgatitja e planit të rishpërndarjes së stomatologëve pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor në shkolla	Dokumenti me funksionet dhe anetarët i miratuar	2022	OSHKSH	DROSHOKSH, NJVKSH	Kosto
	Përgatitja e protokolleve të kujdesit dentar shërbimit profilaktik dhe mjekues	3 Protokolle të miratuara	2022	KSU	MSHMS, OSHKSH, donatorë	
	Përgatitja e kartelës individuale tip për të gjithë fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç	Kartela individuale tip e përgatitur	2022	KSU	MSHMS, Fakulteti i Stomatologjisë, donatorë	
Fuqizimi i punkteve të stomatologjisë pranë shkollave	Investimi në pajisje mjekësore	18 unite të reja dentare	2022	OSHKSH, KSU	MSHMS, donatorë	

dhe Njësive të Vendeve Kujdesit Shëndetësor me pajisje të reja mjekësore		20 autoklava të reja	2023			
		10 unite të reja dentare	2024			
		20 autoklava të reja	2025			
		10 unite të reja dentare	2026			
		10 unite të reja dentare	2028			
Fuqizimi i Shërbimit Stomatologjik pranë vendbanimit	Investimi në pajisje mjekësore për aksesin e zonave rurale	2 klinika dentare të lëvizshme	2023	KSU	MSHMS, donatorë	
Fuqizimi me pajisje mjekësore i Klinikës Stomatologjike Universitare	Investime në pajisje mjekësore të teknologjisë së fundit	Krijimi i kabinetit për trajtimin e problemeve dentare te fëmijët autikë	2023	KSU	MSHMS, donatorë	
Fuqizimi i pikave fokale përgjegjës për kujdesin dentar në nivel rajonal	Përgatitja e programit të një kursi trajnimi mbi trajtimin e fëmijëve në shkolla. Teori dhe praktikë 8-10 ditore pa shkëputje nga puna.	Programi i përgatitur	2023	KSU	OSHKSH rajonale	

	Organizimi i kursit të trajnimit dhe aktivitetet tjera të edukimit në vazhdim.	40 persona të trajnuar	2023	KSU	OSHKSH Rajonale, donatorë, OJQ	
	Organizimi i mbikqyrjes mbështetëse në rajone të përgjeshdhura.	5-10 vizita në vit në NJVKSH dhe spitale rajonale	2023	KSU	OSHKSH Rajonale	
Koordinim informacioni mes KSU, OSHKSH dhe MSHMS për raportet monitoruese	Përgatitje e një rregulloreje/marreveshjeje mbi shkëmbimin e informacionit mbi kujdesin dentar te fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç mes institucioneve qëndrore	Dokumenti i miratuar	2022	MSHMS & MASR	KSU, OSHKSH, DAR, NJVKSH, partnerë,	
	Organizim i një ëorkshopi për vendosjen e standarteve të cilesisë në fushën e informacionit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre	Aktiviteti i kryer me pjesëmarrjen e 20 specialistëve	2023	MSHMS & MASR	KSU, OSHKSH, DAR, NJVKSH, partnerë,	
Ndërtim i ekipeve multidisiplinare mbi kujdesin dentar në nivel sistemi shëndetësor lokal	Përgatitje e një dokumenti mbi punën në ekip për fëmijët me probleme të shëndetit mendor mes shërbimeve në nivel lokal dhe qendror: Synimi, profesionet, institucionet, përgjegjësitë, bashkëpunimi	Dokumenti i përgatitur dhe miratuar	2023	KSU	MSHMS, OSHKSH, NJVKSH, partnerë	

	Pilotimi i modelit dhe mbështetja e tij në disa rajone të përzgjedhura	Të paktën 5 rrethe e praktikojnë modelin e ekipeve multidisiplinare	2023-2025	KSU	MSHMS, OSHKSH, NJVKSH, partnerë	
Forcimi bashkëpunimit me bashkitë për përmirësimin e shëndetit dentar te fëmijët	Seminar me temë kujdesi dentar dhe ekosistemi në bashkëpunim mes institucioneve shëndetësore dhe bashkive të përzgjedhura	Aktiviteti i kryer me pjesëmarrjen e të paktën 30 specialistëve	2023	KSU, OSHKSH	MSHMS, bashki, Universitetet, OJQ, partnerë	
	Monitorimi nga ana e pikave fokale të çdo iniciative për shëndetin nga bashkitë (korsitë e biçikletave, zona të gjelbëruara, kënde sportive për fëmijët, shkolla të shëndetshme etj)	Të paktën 10 raporte monitorimi të përgatitura	2023-2025	OSHKSH rajonale	KSU, bashki, MSHMS, Universitete	
	Krijimi i një rrjeti kombëtar të bashkive për shëndetin	Të paktën 10 bashki pjesëmarrëse	2025-2030	MSHMS	KSU, OSHKSH, bashki, OJQ, partnerë	
Fusha 2. Parandalimi: Aplikim i masave rregullatore						
Objektiva	Aktivitetet	Tregues	Koha	Institucione	Partneret	Kosto
Ulja e barrierave të njohura midis fëmijëve të vegjël	Fuqizimi i prindërve që të marrin vendime pozitive në prindërit/kujdestarët.	Ofrimi i edukimit për shëndetin oral për prindërit/kujdestarët.	2024-2025	MSHMS	Ministri të tjera, ISHP, partnerë	

dhe shërbimeve të shëndetit oral.	lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor oral për fëmijët e tyre.						
Rregullim i shitjes së produkteve ushqimore në mjedise shkollore	Rishikimi i urdhrit të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin lidhur me rregullimin e tregtimit të ushqimeve në mjediset shkollore	Urdhri në zbatim	2023-2024	MSHMS	Ministri tjetra, ISHP, partnerë	të	
	Mbështetja e zbatimit të rregullores me një fushatë informuese në shkolla.	Të paktën një fushatë e zbatuar	2023-2025	MSHMS	Ministri tjetra, ISHP, KSU, partnerë	të	
Fusha 2. Parandalimi: Ndërhyrje në popullatë							
<i>Objektiva</i>	<i>Aktivitet</i>	<i>Tregues</i>	<i>Koha</i>	<i>Institucione</i>	<i>Partnere</i>	<i>Kosto</i>	
Rritja e njohurive mbi kujdesin dentar, menaxhimin e faktorëve të riskut, sjelljen e shëndetshme etj	Ndërtimi i një ëëbsite mbi njohjen e riskut individual dhe kujdesin dentar për fëmijët dhe përditësimi i tij me materiale edukuese dhe instrumente informimi interaktive	Ëëbsite i ndërtuar, funksional dhe me të paktën 10 000 përdorues	2023-2025	MSHMS	OSHKSH, KSU, shkolla, partnerë		

	Organizim i trajnimeve sistematike mbi këshillimin e kujdesit dentar te fëmijët stomatologët e shkollave	Të gjithë mjekët stomatologë të trajnuar	2023-2025	KSU	MSHMS, OSHKSH, partnerë	
	Përgatitje materialesh dhe organizim i trajnimeve sistematike një ditore mbi këshillimin e kujdesit dentar për mësuesit dhe mjekët e shkollave me qëllim krijimin e Trainer of Trainees	Të paktën 200 mësues dhe 50 mjekë të trajnuar	2022-2025	ISHP	MSHMS, OSHKSH, QKEV, universitete, partnerë	
Fushata mbi ushqyerjen e shëndeteshme dhe mbështetjen e ushqimeve lokale.	Fushatë mediatike mbi ushqyerjen e shëndetshme me fokus promovimin e ushqimeve të freskëta lokale (prodhuar nën 60 km nga konsumatori)	Të paktën një fushatë e zbatuar që mbulon të paktën 100 000 qytetarë	2023-2024	KSU	MSHMS, OSHKSH, universitete, partnerë, OJQ	
Promovimi i ushqyerjes së shëndetshme në mjediset shkollore	Prioritizim i ushqyerjes së shëndetshme dhe aktivitetit fizik në rishikimet e programit mësimor. Bashkëpunim mes Ministrive përkatëse dhe mes institucioneve shëndetsore e arsimore në proceset e	Programi i rishikuar dhe përshtatur	2023	MSHMS	Ministri të tjera, ISHP, IZHK, partnerë	

	rishikimit të programit mësimor	4 fushata të realizuara	2023-2025	MSHIMS	KSU, OSHKSH, partnerë	
Përdorimi metodave inovative për të ndikuar në rrjetet e mediave sociale me modele të sjelljes së shëndetshme	Promovimi i modeleve të jetës së shëndetshme në rrjete sociale (përfshi tik-tok, facebook, instagram) duke identifikuar dhe bashkëpunuar me persona me influencë tek të rinjtë dhe fëmijët (përfshi sportistë apo artistë të njohur).					
Adaptimi i aftësive të diagnostës dhe komunikimit të mjekëve për pacientët e vegjël me probleme të shëndetit mendor	Përgatitja e protokolleve dhe e instrumentave specifike për stomatologët lidhur me vlerësimin efektiv dhe komunikimin e përshtatshëm të pacientëve të vegjël me probleme të shëndetit mendor. Këtu do të përfshihen vlerësimi, këshillimi, dhe mjekimi i dhëmbëve	Protokolli klinik dhe instrumentat të përgatitur. 12 punkte të përzgjedhura në 12 qarqet.	2023-2025	MSHIMS	KSU, OSHKSH, Universitete, partnerë	
	Përgatitje e një programi për trajnimin mbi vlerësimin, këshillimin dhe mjekimin e pacientëve të vegjël me	5 kurse të akredituar. 100 pjesëmarrës	2023-2025	KSU	ASCK, OSHKSH, MSHIMS, partnerë	

	probleme të shëndetit mendor në nivel kombëtar. Organizim i kurseve afatshkurtër të trajnimit si pjesë e edukimit të vazhduar							
Fusha 3. Sistemi shëndetësor: Ulja më tej e barrierave në akses								
<i>Objektiva</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Tregues</i>	<i>Koha</i>	<i>Institucione</i>	<i>Partnerë</i>	<i>Kosto</i>		
Ofrimi i shërbimit të kujdesit dentar për zonat rurale të thella për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç nëpërmjet klinikave dentare të lëvizshme.	Përgatitja e kalendarit vjetor të lëvizjes së kabineteve dentare të lëvizshme dhe publikimi në faqen elektronike të institucioneve shtetërore shëndetësore	5,000 fëmijë të depistuar në vit	2023 (fillon programi)	KSU	MSHMS, OSHKSH, NJVKSH, partnerë			
Ofrimi i shërbimit të kujdesit dentar pranë vendbanimit për fëmijët e grupmoshës 6 – 14 vjeç	Përmirësimi i vazhdueshëm i ofrimit të kujdesit dentar për fëmijët në nivel kombëtar.	100,000 fëmijë të depistuar në vit 50,000 fëmijë që kanë marrë trajtim pranë punkteve të shkollave dhe NJVKSH	2023 – në vijim	OSHKSH	KSU, Punktet në shkolla, NJVKSH,			